




Komuna Vushtri
SH.ASheshi "Ahmet Krasniqi" Nr. 10



NPL "Përparimi"
Vushtri, Rr. "Skënderbeu" nr. 82

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 23 paragrafi 3 i Ligjit për prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr.04/L-042 me ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji me Ligjin Nr. 05/L-092 i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr.05/L-068, si dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, me datën 24.06.2021 arrihet kjo::

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR ZHVILLIM TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Palët nënshkruese:

1. Komuna e Vushtrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës **Z. Xhafer Tahiri** (në tekstin e mëtejme Komuna),
2. Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtri, të cilën e përfaqëson **Z. Fadil Bahtiri**, Kryeshf Ekzekutiv (në tekstin e mëtejme Ndërmarrja)

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje të mirëkuptimit është zhvillimi i procedurave të prokurimit publik nga Drejtoria e Prokurimit të komunës së Vushtrisë për nevoja të Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtri.

Neni 2 Obligimet e Komunës

Komuna e Vushtrisë, bazuar në faktin se NPL "Përparimi" SH.A në Vushtri nuk e ka të plotësuar vendin e punës së zyrtarit për prokurim publik, merr përsipër që të zhvilloj procedurat e prokurimit publik për nevoja të kësaj ndërmarrje, duke u bazuar në nenin 23 paragrafi 3 i Ligjit për prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr.04/L-042 me ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji me Ligjin Nr. 05/L-092 i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr.05/L-068.

Neni 3
Obligimet e NPL "Përparimi" SH.A

Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" SH.A (punëdhënësi i ardhshëm) pajtohet që Komuna e Vushtrrisë të zhvilloj procedurat e prokurimit publik për nevoja të saj, siç është theksuar në nenin paraprak të kësaj marrëveshje.

Neni 4
Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 4.1 Kjo marrëveshje e mirëkuptimit do të zgjasë deri në ditën e plotësimit të vendit të punës zyrtar i prokurimit publik në Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" në Vushtri.
- 4.2 Në ditën e plotësimit të vendit të punës të cekur si në paragrafin paraprak, palët nuk kanë asnjë lloj obligimi ndaj njëra tjetrës.
- 4.3 Përjashtimisht të cekurave në pikën paraprake, Komuna e Vushtrrisë do të zhvilloj dhe përfundoj të gjitha procedurat e prokurimit publik të filluara para datës së plotësimit të vendit të punës zyrtar i prokurimit publik në ndërmarrjen e cila është palë nënshkruese e kësaj marrëveshje.

Neni 5
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të cilat mund të lindin gjatë implementimit të kësaj marrëveshje të i zgjidhin me mirëkuptim.

Neni 6
Numri i ekzemplarëve


Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në dy (2) ekzemplarë, nga një (1) për secilën palë nënshkruese.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që kjo marrëveshje e mirëkuptimit hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.


Vushtri, më _____ 2021

Për Komunën e Vushtrrisë


Z. Xhafer Tahiri,
Kryetar i Komunës



Për NPL "Përparimi" SH.A


Z. Fadil Bahri
Kryeshef Ekzekutiv